



MG-730 GRAFIATO



PAKETIMI

25 kg



KOHA E THARJES

24 Ore



KONSUMI

2.4 - 2.8kg/m²

Përkufizimi i Produktit

MG-730 GRAFIATO është një grafiato me bazë çimento për veshje dekorative të ambienteve të jashtme.

Veçoritë

- Ofron mundësi për aplikim të shpjeto falë punueshmërisë së lehtë.
- Dekori bëhet me lehtësi.
- Me performancën e lartë që ka, është rezistent ndaj kushteve ekstreme klimaterike
- Krijon mbi sipërfaqe njo strukture natyrale dhe dekorative, me karakteristikën e veçantë mbushëse që ka materiali.
- Mundëson ajrosjen e murit, fale përshkueshmërisë së avullit.
- Ka aftësi që lagështirën e krijuar brenda në mur ta nxjerrë jashtë dhe të sigurojë ajrosjen e ndërtesave.

Udhëzime për Përdorimin e Produktit

- Sipërfaqet ku do të aplikohet grafiato duhet të pastrohen plotësisht nga pluhuri, papastërtitë, mbetjet vajore e bojrat që mund të pengojnë ngjiten. Sipërfaqet duhet të jenë të pastra dhe të thata. Para se ta aplikoni produktin mbi sipërfaqe të reja me bazë minerale, duhet të siguroheni që kanë kaluar të paktën 28 ditë nga përfundimi i punës me to. Në ndërtesë duhet të jenë marrë të gjitha masat që kanë të bëjnë me hidroizolin.
- Sipërfaqet e vjetra me bazë sintetike duhet të smerilohen mirë me letër smerile dhe pluhuri i krijuar duhet larguar nga sipërfaqja
- Nëse sipërfaqja ka disnivel përdorni llaçin MATIART, për të përfutur një sipërfaqe kompakte dhe të rrafshuar.

-25 kg MG-730 GRAFIATO duhen hedhur me ngadalë në 5.75 – 6.50L ujë të pastër dhe duhen përzier derisa të përfitohet një masë homogjene pa kokrriza. Rekomandohet që përzierja të bëhet me mikser me xhiro të ulët.

-Llaçi i përgatitur duhet line 5- 10 minuta për t'u bërë gati për përdorim dhe duhet përzier përsëri para aplikimit.

-Konsumi është 2.4-2.8 kg/m².

-Aplikojeni MG-730 GRAFIATO mbi sipërfaqe me një mallë inoksi, sa hapësira e kërkuar e mbushjes. Jepini teksture (dekor) sipërfaqes, duke bërë lëvizje rrethore me një malle plastike.

-Llaçin që keni përgatitur, konsumojeni brenda 3 orëve. Llaçi të cilit i ka kaluar koha e përdorimit, duhet hedhur poshtë.

-Ne sipërfaqet që janë në vazhdimësi me njëra-tjetrën, produktin aplikojeni me një dorë.

-MG-730 GRAFIATO nuk lihet mbi sipërfaqe si dorë e fundit. Pasi të jetë tharë, sipërfaqja duhet lye me bojë.

-Mos i shtoni produktit asnjë aditiv tjetër që nuk është i shkruar në udhëzimin e aplikimit.

-Sigurohuni që temperatura e ajrit dhe sipërfaqes të jetë mbi +5°C dhe sipërfaqja nuk është e lagur nga shiu gjatë aplikimit dhe në 24 orët në vijim.

-Produkti nuk duhet përdorur në kushtet atmosferike si temperatura shumë të larta, nën rrezatimin direkt të diellit, erë të fortë, mjegull, lagështirë të lartë relative apo kur pritët të bjerë shi. Sipërfaqet e nxehta duhen lagur para se të behet aplikimi.

-Për të shmangur mbivendosjen në sipërfaqe të mëdha ose pas pushimeve gjate punës, duhet të përdorni ngjitës letre ose fuqi punëtore shtesë, për t'u siguruar që materiali do të aplikohet mbi produktin e njomë pa nderprerje.

-Vlerat e mësipërme janë dhënë për kushtet e një mjedisi me temperature $23^{\circ}\text{C}\pm 2$ dhe lagështirë relative $50\%\pm 5$. Këto vlera mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të mjedisit.

-Temperatura e zbatimit të produktit dhe kushtet e magazinimit duhet të jenë ndërmjet $+5^{\circ}\text{C}$ dhe $+35^{\circ}\text{C}$.

-Materiali nuk duhet të përdoret në sipërfaqe horizontale të ekspozuara ndaj shiut ose lageshtires.

Jetëgjatësia në raft

12 muaj në ambient të thatë dhe ambalazh të pahapur,

Magazinimi

Produktin ruajeni në vend të thatë dhe thasët vendosini në stivë e shumta në 10 kate.

SKEDA TEKNIKE (NË $+23^{\circ}\text{C}$ DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	E bardhe
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	5.75-6.5 L / 25 kg
Konsumi	2.4-2.8 kg/m ²
Temperatura e Aplikimit	($+5^{\circ}\text{C}$) - ($+35^{\circ}\text{C}$)
Densiteti	1400 $\pm$ 100 kg/m ³
Forc e lidhjes (EN 1015-12)	$\geq 0.45 \text{ N/mm}^2$ /B
Rezistenca ne shtypje (EN 1015-11)	3.5-7.5 N/mm ² -CS III
Absorbimi kapilar i ujit (EN ISO 1062-3)	$< 0.1 \text{ kg/m}^2\text{h}^{0.5}$
Rezistenca ndaj nxehtësisë	(-30°C) - ($+80^{\circ}\text{C}$)
Reagimi ndaj zjarrit	Bs1d0
Lëshimi i substancave të rrezikshme	Shiko SDS